

VENDIM
Nr. 240, datë 24.4.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 730, DATË 20.10.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
KUSHTET, KRITERET, TARIFAT, AFATET DHE PROCEDURËN PËR
KLASIFIKIMIN E STRUKTURAVE AKOMODUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 45, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Paraqitja e aplikimeve përmes portalit qeveritar “*e-Albania*”, si dhe kthimi i përgjigjeve për aplikimet nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, me vulë elektronike, hyn në fuqi pas ngritjes dhe funksionimit të plotë të Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Turizmit. Deri në ngritjen dhe funksionimin e plotë të sistemit, paraqitja e aplikimeve, si dhe përgjigjet për aplikimet dërgohen sipas përcaktimeve në fuqi në kohën e paraqitjes së tyre.”

2. Në pikën 3, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohet me “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”.

3. Në rregulloren për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese, që i bashkëlidhet vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) kudo në përmbajtjen e rregullores, fjalët “kërkesa/kërkesën/kërkesës” dhe “kërkuesi/kërkuesit/kërkuesin” zëvendësohen përkatësisht me “aplikimi/aplikimin/aplikimit” dhe “aplikuesi/aplikuesit/aplikuesin”;

b) në pikën 1, të nenit 1, fjalët “... dhe kategorizimin ...” hiqen;

c) në pikën 2, të nenit 3, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) “Aplikim nga subjekti ose sipërmarrësi turistik”, është aplikimi *on-line*, nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” për klasifikim, riklasifikim, rinovim të vlerësimit të strukturës akomoduese, si dhe ndryshim të të dhënave në certifikatë.”

ii. shkronja “c/1” shfuqizohet;

ç) titulli i kreut II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KLASIFIKIMI I STRUKTURAVE AKOMODUESE”.

d) neni 4 shfuqizohet;

dh) në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

i. pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Çdo sipërmarrës turistik, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, pajiset me certifikatë klasifikimi për ushtrimin e këtij aktiviteti.”

ii. pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Komisioni klasifikon çdo strukturë akomoduese, mbështetur në kushtet dhe kriteret e parashikuara në këtë rregullore dhe në aneksin nr. 1 “Kushtet dhe kriteret e klasifikimit”, bashkëlidhur këtij vendimi.”;

e) pika 1, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Sipërmarrësi turistik, që ushtron veprimtarinë strukturë akomoduese, duhet të paraqesë nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” aplikimin për pajisjen me certifikatë klasifikimi, duke plotësuar formularin elektronik.”;

ë) në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

i. në pikat 2 dhe 3, pas fjalëve "... ministria njofton kërkuesin ..." shtohen "... elektronikisht, nëpërmjet portalit qeveritar *"e-Albania"* ...";

ii. në pikën 7, fjalët "... me shkrim ..." zëvendësohen me "... elektronikisht, nëpërmjet portalit qeveritar *"e-Albania"* ...";

f) në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

i. në pikën 2, fjalët "... një njoftim me shkrim ..." zëvendësohen me "... njoftimin elektronikisht, nëpërmjet portalit qeveritar *"e-Albania"* ...";

ii. në shkronjën "a", të pikës 3, pas fjalëve "Lëshimin e certifikatës së klasifikimit ..." shtohen "... me vulë elektronike, nëpërmjet portalit qeveritar *"e-Albania"* ...";

g) në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

i. pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Komisioni, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e vendimit për përcaktimin e nivelit të klasifikimit, përgatit certifikatën e klasifikimit me nënshkrim elektronik/dhe me vulë elektronike dhe ia dërgon aplikuesit nëpërmjet portalit qeveritar *"e-Albania"*".

ii. fjalia hyrëse e pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Certifikata e klasifikimit nënshkruhet elektronikisht nga ministri ose personi i autorizuar prej tij dhe përmban:".

iii. pika 3 shfuqizohet.

gj) pika 1, e nenit 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Sipërmarrësi turistik, i cili zotëron një certifikatë klasifikimi, në rastet kur kanë ndodhur ndryshime në të dhënat e paraqitura për marrjen e saj ose çdo ndryshim, që mund të ndikojë në klasifikimin e strukturës akomoduese, brenda 7 (shtatë) ditëve nga ndodhja e tyre, aplikon në portalin qeveritar *"e-Albania"*".

II. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku